



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 94, datë 29.07.2020

UDHËZIM

MBI
PRITSHMËRITË RREGULLATORE NDAJ SUBJEKTEVE NËN MBIKËQYRJE, PËR
SHKAK TË SITUATËS SË KRIJUAR NGA COVID-19

Në bazë dhe për zbatim të neneve 3, 12, dhe 14, pikat 2 dhe 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar,

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

Duke vlerësuar se si pasojë e pandemisë globale COVID-19, autoritetet rregullatore në të gjithë shtetet janë detyruar të ndërmarrin masa për kalimin e situatës në mënyrën më efektive të mundshme;

Duke qenë se me vendimin nr. 56, datë 10.04.2020, ka ndaluar shpërndarjen e fitimit në formën e dividendëve ose të dividendëve të ndërmjetëm ose në formën e pagesave të bazuara në pjesëmarrjen në fitim të anëtarëve të këshillit të administrimit/mbikëqyrës të shoqërisë apo punonjësve të tjerë;

Duke monitoruar situatën, ka kërkuar të gjithë operatorëve të tregjeve nën mbikëqyrje që të përditësojnë dhe të kenë funksionale plane të vazhdimësisë së veprimtarisë dhe planet e përballimit të krizave, ku të detajohen të gjithë elementët teknikë, logjistikë, njerëzorë dhe financiarë për përballimin e efekteve të mundshme;

Duke përmbushur misionin, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar si dhe transparencë për konsumatorin dhe investitorin, ka vijuar monitorimin e subjekteve nën mbikëqyrje dhe në linjë

me rekomandimet e rregullatorëve të tjerë homologë, për të lehtësuar ndikimin e COVID-19, ka kërkuar nga subjektet nën mbikëqyrje, marrjen e masave dhe kujdes të shtuar.

Në këto kushte,

Bordi i Autoritetit, udhëzon shoqëritë e sigurimit:

- 1. Të marrin masat për të siguruar vazhdimësinë e biznesit duke përfshirë rreziqet që shkakton situata pandemike si dhe të depozitojnë në Autoritet planet e rishikuara për vijimin e veprimtarisë dhe përballimin e krizave.**
- 2. Të mbajnë nivelin e përshtatshëm të likuiditetit si dhe të marrin masa të tjera të nevojshme për të ruajtur pozicionin e treguesve si dhe të informojnë menjëherë Autoritetin në rast të shkeljes së këtyre treguesve.**
- 3. Të shikojnë mundësinë e ndryshimit të marrëveshjeve të risigurimit, për të kufizuar ekspozimin ndaj COVID-19, duke marrë në konsideratë një nivel mbajtjeje agregate, për të gjitha ngjarjet që mund të ndodhin brenda vitit si pasojë e COVID-19.**
- 4. Të garantojnë që informacioni që i komunikohet personit të siguruar mbi të drejtat kontraktuale të jetë i qartë, i mjaftueshëm dhe në kohë, duke orientuar edhe ndërmjetësit që veprojnë për llogari të tyre lidhur me këtë detyrim.**
- 5. Të marrin masa për të përditësuar faqet zyrtare të internetit, me seksione të dedikuara lidhur me ndikimin e pandemisë shkaktuar nga COVID-19, duke pasqyruar dhe masat e marra nga vetë shoqëria e sigurimit.**
- 6. Të rishikojnë kushtet e kontratave të sigurimit, për të reflektuar çdo ndryshim të ekspozimit të risqeve gjatë periudhës së pandemisë. Për produktet që lidhen me mbulimin nga pandemitë, të qartësohen mbulimet e tyre në raste të ndodhjes së ngjarjeve të siguruara.**
- 7. Të kryejnë një vlerësim të produkteve të cilat mund të ndikohen nga pandemia duke informuar personat e siguruar.**
- 8. Të përditësojnë udhëzimet/procedurat e marrjes në sigurim në vijim të ngjarjes së COVID – 19.**

Bordi i Autoritetit, udhëzon shoqëritë administruese:

- 1. Të rishikojnë planet e vazhdimësisë së veprimtarisë në drejtim të adresimit të të gjitha rreziqeve që vijnë si rrjedhojë e situatës pandemike, duke hartuar shtojca të dedikuara në lidhje me situatën e COVID-19. Të gjitha planet e vazhdimësisë së biznesit të ridepozitohen në Autoritet.**

2. Të bëjnë transparente sa më parë të jetë e mundur çdo informacion të rëndësishëm që lidhet me COVID-19, duke përditësuar faqet zyrtare të internetit, me seksione të dedikuara lidhur me ndikimin e pandemisë shkaktuar nga COVID-19, duke pasqyruar dhe masat e marra nga vetë shoqëria administruese.
3. Të rivlerësojnë treguesin sintetik të përfitimit dhe rrezikut në drejtim të përditësimit të dokumentit me informacionin kyç për investitorin.
4. Të kenë një vëmendje të shtuar ndaj administrimit të rrezikut, si dhe të monitorojnë vazhdimisht plotësimin e parametrave ligjorë dhe rregullatorë, si dhe të informojnë menjëherë autoritetin në rast të shkeljes së këtyre parametrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE